

VENDIM
Nr.51, datë 9.5.2008

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “E-VENTO
S.R.L. ALBANIA” SHPK**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13, pika 1 germa “a” dhe 8, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 10 të “Rregullores për procedurat e licencimit”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007 dhe nenit 18 pika 3 të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr.44, datë 24.7.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.5.2008, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “E-Vento s.r.l. Albania” sh.p.k., për t’u licencuar në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimi i energjisë elektrike, dhe konstatoi paraqitjen e plotë të dokumentacionit të përcaktuar në rregulloren e procedurave të licencimit,

VENDOSI:

1. Të fillojnë procedurat për licencimin e shoqërisë “E-Vent s.r.l. Albania” sh.p.k. në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike prej tyre.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta